

MUSHKONJA AZIATIKE TIGËR



Vjen nga Azia juglindore.

Për herë të parë tek ne është zbuluar në rajonin juglindor dhe në gusht të vitit 2016 nga ekipi entomologjik i Qendrës për Shëndet Publik - Shkup. Sot, ajo është zgjeruar edhe në vendbanimet rreth stacionit të Ri Hekurudhor në Shkup.

Ata kafshojne gjatë ditës dhe janë transmetues të mundshëm potencial të sëmundjeve të tilla si Denga, Çikungunija dhe Zika.

Si mund ta parandalojmë zgjerimin e tyre? Duhet të merren masa individuale dhe kolektive për të eliminuar të gjitha vendet potenciale për mbarështimin e tyre.

DETYRAT E INSTITUCIONEVE

Ministria e Shëndetësisë, Instituti i Shëndetit Publik, Qendrat për Shëndet Publik, Fakulteti i Bujqësisë dhe Shkencave Ushqimore, Fakulteti i Mjekësisë Veterinare, Fakulteti i Shkencave Natyrore (Instituti i Biologjisë) duhet të pregaditin një program nderkombëtar për mbikëqyrjen e mushkonjave invazive dhe kontrollit të tyre, Plan Akcion, Elaborat për zbatim të dezinfekcionit si masë mbrojtëse preventive nga sëmundjet infektive.

Njësitet e vetëqeverisjes vendore financojnë dhe zbatojnë masa për të kontrolluar vektorët (mushkonjat).

Qyteti i Shkupit finanson dhe zbaton kryerjen e dezinfekcionit si masë preventive në 10

komunat e qytetit ndërsa 7 komunat tjera periferike apo rurale këtë e zbatojnë nga mjetet e veta.

KUIZ

1. Vetëm femrat hedhin vezë?

Po Jo

2. Sa herë mundet një mushkonje aziatike tigër të hedhë vezë gjatë gjithë jetës?

Një herë 5 herë 10 herë

3. Vetëm meshkujt kafshojnë?

Po Jo

4. Femrat marrin një vakt gjaku për të hedhur vezë

Po Jo

5. Çdo femër mund të hedhë 150 vezë në të njëjtën kohë

Po Jo

6. Faza e zhvillimit të larves zgjat rreth

1 dite 5 ditë 10 muaj

7. Mushkonjat gjatë dimrit hibernojnë

Po Jo

8. Mushkonja aziatike Tigër kafshon vetëm gjatë natës

Po Jo

9. Parandalimi i mushkonjave Aziatike Tiger nga qasja në ujë është një mënyrë efektive për ta ndaluar shtimin e tyre.

Po Jo

10. Mushkonjat aziatike Tigër mund të jenë vektorë apo bartës të sëmundjeve

Po Jo

përgjigje

1. Po ; 2. Më shumë se 5 herë ; 3. Jo, vetëm femrat kafshojnë ; 4. Po ; 5. Po; 6. 5 ditë ; 7. Po ; 8. Jo, është aktive gjatë ditës ; 9. Po, pa enë me ujë nuk mund të mbijetojë ; 10. po, Zika, Denga dhe Çikungunija

MUSHKONJA AZIATIKE TIGËR



AKTIVIZOHU NË LUFTË PARA SE TË KAFSHOHENI

KUJDESUNI QË MJETET E KOPSHTIT TË MOS MBAJNË UJË



KUJDESUNI PËR TA SI DUHET, MBULONI ATO, ZBRAZNI ATO



Qendra për Shëndet Publik në Shkup
Rr. 3-ta Makedonska brigada No.18 Shkup,
tel. 02/3298 667,
faks 02/3298 251,
www.cph.mk

превземено од:




SHËRBIMIN E DDD

02 2611 582
076/350-108

TË DHËNAT KRYESORE

| | |
|-----------------------------|--|
| Emri popullor Emri latin | mushkonja Aziatike Tigër <i>Aedes albopictus</i> |
| Madhësia | 5-10 mm |
| Prejardhja | Azia Juglindore |
| Jetëgjatësia | Një muaj |
| Cikli reproduktiv | Një femër lëshon më shumë se 150 vezë gjatë jetëgjatësisë së saj |
| Lokalizimi | Shkup (per reth stacionit te Ri Hekurudhor, I.Trianglla), Strumic, Gjevgjeli, Dojran |

CIKLI I ZHVILLIMIT



MASAT MBROJTËSE

Gjithcka fillon prej në shtëpi. Mushkonja Aziatike Tigër zhvillohet aty ku ka ujë, madje edhe një pikë ujë është e mjaftueshme për zhvillimin e saj. Prandaj është e nevojshme që gjdo sipërfaqe ujore që gjendet në ambient të hapur të largohet dhe të zbrazet. Duke ndërmarrë veprime të përbashkëta do të kemi sukses në luftim që mushkonjat të mos vijnë në kontakt me ujin.




1

MJETE KOPSHTI DHE LODRA
Sigurohuni që çdo gjë që ka mbetur jashtë nuk është më një vend i mundshëm për shtimin e mushkonjave nga mjetet dhe lodrat. Prandaj gjithçka duhet të zbrazet, të kthehet prapsht ose të largohet.

2

MBETURINAT
Të largohen të gjitha mbeturinat që mund të përmbajnë sasi të ujit.



5

Mirëmbajtja e rregullt E CATISË, HENDEKEVE SI DHE KANALEVE TË UJËSJELLËSVE. TË PASTROHET ME KUJDES QË UJI TË MUND TË RRJEDHË, TË MOS QËNDROJË.



6

REZERVUARET E UJIT DHE MBLËDHËSIT E UJRAVE TË SHIUT.
Të mbyllen mirë dhe të mbulohen me rrjete ose mbulues me insekticid

3

PJATAT NDËR SAKSITË E LULEVE, VAZOT, KOVAT
Të zbrazen më shpesh (më së paku një herë në javë)



4

BAZENE DHE PELLGJE KOPSHTESH
Mirëmbajeni ujin rregullisht, ndrojeni dhe pastrojeni në mënyrë mekanike sipërfaqen e ujit nga mbetjet bimore.



VËREJTJE

QË TË KENI NJË VERË PA BRENGA VENDOSNI NË PJATAT E SAKSIVË TË LULEVE RËRË. NË KËTË MËNYRË BIMËT DO TA KENË LAGËSHTINË E DUHUR PA QENË VEND PËR ZHVILLIMIN E LARVAVE TË MUSHKONJAVE AZIATIKE TIGËR